

# **PRAKTIKA TË MIRA PËR TË NXËNËT NË KLASË NGA MËSUESIT E EKIPIT LËNDOR TË GJUHËVE TË HUAJA**

## **1.METODA “PUNË NË GRUPE” TIC -TAC-TOE GAME**

Në orën mësimore të lëndës gjuhës angleze, klasa 7b, me temë mësimore ‘Past simple and present perfect’ dhe me koncept kryesor përdorimi i kohës ‘past simple and present perfect’ në situata të ndryshme, duke përdorur punën në grupe ‘Tic -tac-toe’ u mundësua një përfshirje aktive dhe e plotë e të gjithë nxënësve në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Unë futem në klasë dhe informoj nxënësit për aktivitetin e përgatitur, që do të zhvillohet në klasë, duke marrë parasysh qëllimin që po përdoret kjo teknikë.
- Nxënësit informohen në lidhje me rregullat e aktivitetit që do të zhvillohet hap pas hapi. Ato do të ilustrojnë pyetjet e përgatitura nga vetë mësuesja duke i lejuar të punojnë në mënyrë të pavarur si fillim dhe me pas të gjithë bashkohen një qëllimi, që grupi me më shumë përgjigje të sakta të dali dhe grupi fitues.
- Si fillim unë i ndaj nxënësit në 4 grupe (A,B,C,D) nga ku secili grup është i përbërë nga 6 nxënës. Ndarja e grupeve bëhet në mënyrë të rastësishme, me nxënës të niveleve të ndryshme. Secilit grup i kërkohet të zgjedhe një nxënë, i cili do të jetë në smart-board për të luajtur lojën tic-tac-toe.
- I shpjegoj nxënësve që në kutinë që unë mbaj në dorë ndodhen të palosura copëza letre me pyetje nga më të ndryshmet ,për kohën past simple dhe present perfect . Nxënësit marrin në mënyrë të rastësishme, nje letër nga kutia dhe pasi që te gjithë nxënësit e 4 grupeve pajisen me letra , fillojmë lojën.
- Ne baze të uljes në bankë, nxënësit fillojnë sipas një rradhe leximin e pyetjes dhe japin përgjigjen e saj (në këtë mënyrë shmangim kaosin dhe rrëmujën gjatë lojës.).Pyetjet që nxënësi ka në letër janë të tilla si: Make a sentence in present perfect with verb ‘go’.Mention four time expressions in past simple tense.
- Nxënësi i cili i përgjigjet saktë pyetjes së zgjedhur, i jep të drejtë përfaqësuesit të grupit të tij/saj të plotësojë në tabelë lojën tic – tac-toe. Sa më shumë përgjigje të sakta jep grupi aq më shumë qëndron mundësia që të shpallet grupi fitues në tic-tac-toe.
- Sakaq nxënësit që luajnë lojën në tabelë janë grupi A/Grupi B që plotësojnë nje tabel tic-tac -toe dhe grupi C /grupi D një tabelë tic-tac-toe. Nxënësit tregojnë përpikëmeri në dhënien e përgjigjeve dhe adrenalinë në të njëjtën kohë që plotësojnë tic -tac-toe.
- Kjo tregon një gjithëpërfshirje të nxënësve dhe një orë gramatike në gjuhën angleze , që mësohet dhe reflektohet në të duke u argëtuar në të njëjtën kohë . Ky aktivitet zgjati 17 minuta dhe në fund të lojës dolën fitues 2 grupe.
- Në përfundim të aktivitetit nxënësit morën letra bosh dhe në to shkruajtën opinionet e tyre për grupin që u përgjigj me saktë dhe tregoi përfshirje në lojën e bërë. Komentet që nxënësit bënë në këtë rastë ishin si një reflektim në atë që ne zhvilluam në procesin mësimor dhe që të gjithë ishin të gatshëm të shkruanin opinionin e tyre.

Përdorimi i punës në grupe është gjithmonë një zgjedhje e duhur kur kërkohet gjithëpërfshirje dhe përvetësim njohurish në mënyrë efektive dhe argëtuese.

Mësuesja: Bajame Kamberi

[bajame.kamberi@gea.edu.al](mailto:bajame.kamberi@gea.edu.al)

## 2.METODA “PUNË NË GRUPE-PANTOMIMË”

Në orën mësimore të lëndës gjuhë angleze, klasa 3C, me temë mësimore ‘Përsëritje’ dhe me koncept kryesor përdorimin e kohës së foljes “Present Continuous”, metoda e parashikuar në planin e orës mësimore “Miming game” më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Mësuesja informon nxënësit për aktivitetin që do të zhvillohet dhe qëllimin e tij (përdorimi i kohës Present Continuous në pyetje dhe përgjigje dhe përsëritja e fjalorit).
- Informohen nxënësit që udhëzimet do t'i marrin hap pas hapi. Do të demonstrojmë aktivitetin me njërin nga grupet dhe më pas do të vazhdohet me punën e pavarur nga të gjitha grupet.
- Si fillim, mësuesja organizon klasën në grupe me nga 4 nxënës. Grupet janë të rastësishme, me nivele të përziera; grupim ky më efikas si në të nxënë ashtu edhe në organizim, thjesht nxënësit e bankave të para dhe të treta kthehen pas.
- Mësuesja shpërndan nga 8 karta të kthyera përmbys për secilin grup dhe u kërkon nxënësve të mos i hapin për momentin. Në secilën kartë është e shënuar një folje që tregon një veprim (foljet janë zgjedhur nga fjalët e reja që nxënësit kanë mësuar në klasë të tretë).
- Nëpërmjet rrotullimit të një lapsi, zgjidhet lojtari i parë i secilit grup. (Mësuesja monitoron procesin në secilin grup.)
- Mësuesja i kërkon të gjithë nxënësve të shohin me vëmendje si do ta zhvillojë grupi i parë aktivitetin në mënyrë që më pas ata të vazhdojnë të pavarur.
- Mësuesja i kërkon lojtarit të parë të grupit të parë të zgjedhë një kartë dhe të imitojë/bëjë veprimin që thotë karta (p.sh fle/kërcej/këndoj etj.). Nxënësit e grupit, me radhë ftohen t'i bëjnë pyetje për të zbuluar çfarë po bën lojtari i parë duke përdorur strukturën e fjalive pyetëse në Present Continuous (p.sh Are you dancing?/Are you sleeping? etj.).Lojtari i parë përgjigjet duke përdorur strukturën e përgjigjeve të shkurtra në Present Continuous (Yes, I am. / No, I'm not.).
- Nxënësi, i cili gjen çfarë është duke bërë lojtari i parë, e fiton atë kartë dhe zgjedh një kartë tjetër për të imituar. Mësuesja u thotë nxënësve që kështu do të vazhdojë procesi deri sa të gjitha kartat të përfundojnë. Nxënësi me më shumë karta të fituara në secilin grup do të shpallet lojtari më i mirë ndërsa grupi që nuk ka asnjë anëtar pa karta do të shpallet grupi më i mirë.Mësuesja sigurohet që të gjitha grupet e kanë të qartë si ta zhvillojnë aktivitetin.
- Ndërkohë që nxënësit janë duke punuar të pavarur, mësuesja kalon tek secili grup për t'u siguruar që nxënësit janë duke përdorur strukturën e duhur të ndërtimit të pyetjeve dhe përgjigjeve.
- Në këtë aktivitet nxënësit punuan të pavarur, duke u angazhuar të gjithë, por dhe unë si mësuese kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, veprimtari kjo e cila zgjati rreth 15 minuta.

Në përfundim të aktivitetit u vu re që nuk kishte asnjë nxënës pa karta, gjë e cila dëshmon që rezultatet e të nxënësve që ishin vendosur për ato koncepte të rëndësishme të orës mësimore, ishin arritur plotësisht nga të gjithë nxënësit.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe, të kombinuar dhe të përshtatur në mënyra nga më të ndryshmet me lojra e aktivitete pasi krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Elda Memishaj

[elda.memishaj@gea.edu.al](mailto:elda.memishaj@gea.edu.al)

### **3.METODA “HOT POTATO”**

“Patatja e nxehtë” është një metodë mësimore bashkëpunuese me ritme të shpejta që promovon kontributin e një sërë idesh të ndryshme. Qëllimi i kësaj metode është ta bëjë mësimin më tërheqës dhe të rrisë përqëndrimin. Kjo metodë i shtyn nxënësit të mendojnë shpejt dhe të krijojnë ide, fjale apo fjali të ndryshme. Për nxënësit me stil të parapëlqyer, kinestetik kjo lojë është e duhura. Unë e përdor këtë metodë në shumë orë mësimore në këtë mënyrë:

- Patate e nxehtë (është përdorur si përsëritje e orës së kaluar, warm up activity)
- Nxënësit krijojnë një rreth.
- “Patatja e nxehtë” formohet me letra duke bërë një top. U shpjegoj nxënësve që duhet të krijojnë fjali duke përdorur kohën e shkuar.
- Nxënësit e kalojnë topin tek njëri-tjetri. Them, ndalo! Nxënësi që mban topin duhet të thotë fjalinë e tij/saj duke përdorur strukturën e saktë të kohës së shkuar. Nëse e thotë saktë e kalon “pataten” tek nxënësit e tjerë, nëse e thotë gabim kërkoj nga nxënësit që të presin rradhën që ta korigjojnë.
- Nxënësit luajnë deri në momentin që të gjithë kanë thënë fjalinë e tyre.

Kjo metodë është mjaft e efektshme të përdoret, sepse të gjithë nxënësit flasin me rregullat e drejtshqiptimit të gjuhës nagleze dhe shprehin dhe mendimet e tyre, por dhe lehtëson dhe të nxënësit e mësimin të ri që ka ora mësimore, sespe përdorne fjalët e reja të thëna në rreth.

Mësuesja: Marinela Marku

[marinela.marku@gea.edu.al](mailto:marinela.marku@gea.edu.al)

### **4.METODA DHE TEKNIKA TË EFEKTSHME PËR TË NXËNËT NË ORËT MËSIMORE TË GJUHËS ANGLEZE NË KLASAT 10-12.**

Në shumë orë mësimore të gjuhës angleze të klasave 10-12 përdor shpesh metoda dhe teknika për të nxënësit, të cilat më kanë rezultuar të suksesshme, sepse më kanë siguruar një përfshirje të lartë të të gjithë nxënësve në të nxënë, por dhe më kanë mundësuar arritjen e rezultateve të të nxënësve. Ato janë:

- *Pyetjet e njëpasnjëshme* janë të efektshme, sepse i angazhojnë nxënësit në një proces dinamik dhe reflektues, duke nxitur mendim më të thellë, analizë kritike dhe të folur. Përdorimi i kësaj teknike është i vlefshëm për zbulimin e njohurive, promovimin e vetëdijes dhe lehtësimin e zgjidhjeve të problemeve të ndryshme.
- *Lojërat me shkrim* janë një teknikë motivuese, që mund të pasurojë procesin e të shkruarit. Ato stimulojnë krijimtarinë, përmirësojnë aftësitë e të shkruarit dhe ofrojnë një mënyrë argëtuese dhe bashkëpunuese për t'u angazhuar me artin e të folurit. Lojërat me shkrim ndikojnë në zhvillimin e aftësisë së të shkruarit, por dhe u japin kënaqësi nxënësve për shkrimet që ata hartojnë.
- Një mori teknikash, të përdorura njëra pas tjetrës gjatë hartimit të një shkrimi të pavarur, p.sh një eseje nga nxënësit, janë: *Hulumtimi, stuhi mendimesh, prezantimi i zgjidhjes, mbështetja e zgjidhjes bazuar në evidencë, strukturimi logjik i esesë, redaktimi dhe rishikimi, vetëvlerësimi*, të cilat kanë dëshmuar se ato janë të efektshme, kur zhvillohen të ndërlidhura midis tyre dhe njëra pas tjetrës, sepse vetëm në këtë mënyrë krijojnë një cikël përmirësimi të vazhdueshëm. Hulumtimi i mundëson nxënësit gjetjen e skenarit të shkrimit/produktit që do të hartojë. Më pas stuhia e mendimeve i jep zgjidhjet dhe prezantimin e qartë të përmbajtjes, kurse mbështetja e zgjidhjeve të problemeve me evidencë dhe strukturimi logjik i mundëson nxënësit një të menduar me shkrim në mënyrë logjike dhe të fortë, gjë që siguron se produkti i shkruar, përfundimtar të jetë i qartë dhe kuptueshëm. Vetëvlerësimi, më pas, siguron që produkti i hartuar përmbush qëllimet dhe kërkesat e vendosura nga mësuesi/ja për produktin e kërkuar.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që t'i përdorin sa më shpesh metodat dhe teknikat e trajtuara më lart, sepse ato krijojnë një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Silvana Daci

[s.daci@gea.edu.al](mailto:s.daci@gea.edu.al)